REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 722 / 20
Datë/Datum. 12 · 10 · 2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi ***Dior Halili***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***01/10/2020***	*Data e dorëzimit të raportit* ***12/10/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.09.2020, **OE "Matcal Solutions SH.P.K" Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **722/20**, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, gjegjësisht LOT 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"LOT II-"Vendosja e ndriqimit në vendëkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë"** me nr. të prokurimit: **612-20-2868-5-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Fushë Kosovë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: procedurë e hapur, lloji i kontratës: punë, ndarja në pjesë: po, vlera e parashikuar e kontratës për Lot 2: 92,000€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.
Data e njoftimit për kontratë 15.06.2020
Data e hapjes së ofertës 06.07.2020
Data e njoftimit për dhënien e kontratës 17.07.2020
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm 17.07.2020
Data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim: 22.07.2020
Data e vendimit të AK mbi kërkesën për rishqyrtim: 24.07.2020
Data e ankesës në OSHP: 03.08.2020
Data e vendimit të Panelit të OSHP-së: 04.09.2020
Data e vendimit të AK për anulim: 08.09.2020

Data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim: 13.09.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Me datën: 24.09.2020, **OE "Matcal Solutions SH.P.K" Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **722/20**, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, gjegjësisht LOT 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"LOT II-"Vendosja e ndriqimit në vendëkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë"** me nr. të prokurimit: **612-20-2868-5-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Fushë Kosovë.**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar
Neni 43 – RrUOPP-se – Njotimi i tenderueseve kandidateve.
Neni 64 - Dështmitë e kërkesave
Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Ne me date 04.09.2020 kemi pranuar vendimin e OSHP-se me te cilin vertetohen shkeljet ligjore qe i ka bere AK me rastin e vleresimit te tenderit, pasi qe ka urdheruar AK, qe lenden ta kthej ne rivleresim. Shprehimisht ne vendimin e panelit shqyrtues me nr. Psh.nr. 534/20, kane thene:

Paneli Shqyrtues sqaron se AK në vendimin për anulim për LOT 2 ka dhënë arsye se LOT 2 anulohet për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik që kanë ofertuar nuk janë të përgjegjshëm me dokumentacionin e kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, duke pasur parsysh që AK nuk ka dhënë arsyet e eliminimit, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 të LPP, ku ky nen ka përcaktuar që kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim, ku njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbajë informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me: në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati, në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë. Andaj, ky pretendim është i bazuar.

Perseri si ne heren e pare Komisionii vleresimit te AK nuk e merr per baze vendimin e OSHP-se dhe e anulon aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin:

ARSYETIM

Jeni eleminuar per arsye se nuk keni përmbushur kerkesen 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1 dhe 2 qeshte kërkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate si dhe nuk e përmbushni kriterin e çmimit me te ulet.

Nuk na jep asnje shpjegim se pse ne nuk e plotesojme kerkesat ne piken 9.1&9.2 te dosjes se tenderit.

Ne jemi te bindur se i ploesojme te gjitha kriteret e kerkuara ne dosje te tenderit dhe te njoftimin per kontrate dhe nuk ka asnje arsye per te na eliminuar si tenderues i papergjegjshem, e me pastaj per ta anauluar aktivitetin e prokurimit.

Ne piken 9.1&9.2 per LOT II k:

1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 322 500.00 euro per LOT I, dhe **138 000.00 euro per LOT II.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme.**

Ne per kete pike e kemi dorezuar nje lite te projekteve te nagjshme qe vlera e tyre eshte me shume 4.5 million euro, e ketu jane kerkuara vetem 138 000.00,

Per me teper e kemi nje kontrate identike me keto produkte te kerkuara qe e kemi realizuar per qytetin e prishtines qe eshte ne vlere prej:

PJESA I E KONTRATËS: **KONTRATA**

KOMUNA E PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grupi I OE: NTSH "Eko Invest" & "Drini Company" Shpk: me lider NTSH "Eko Invest", me adresë në Prishtinë me numër te regjistrimit te biznesit dhe numër fiskal 810906620, përfaqësuar nga Bahri Asllani, drejtor (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

Titulli: Ndërtimi i semaforëve, modernizimi dhe pajisjet tjera për siguri në komunikacion

me numër identifikues: Nr. 616 19 098 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit **Ndërtimi i semaforëve, modernizimi dhe pajisjet tjera për siguri në komunikacion** sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Vendi i kryerjes së punimeve është në Prishtinë sipas kërkesave te zyrtareve te AK. Fillimi i realizimit të kësaj kontrate do të bëhet nga dita e caktuar në planin e menaxhimit të kontratës për fillim të punimeve, ndërsa afati kohor për përfundimin e punimeve është 120 ditë kalanderike nga dita e caktuar në planin e menaxhimit të kontratës për fillim të punimeve, i cili do të konstatohet sipas ditarit të punës.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **149.576,^{00} €, (Njeqind e katerdhjetë e nëntë mije e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashte euro e zero eurocent).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione. Situacionet paguhen pas përfundimit të punëve në vlerë prej 50,000.^{00} € apo edhe me tepër me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit i caktuar me vendim nga ZKA.

Pagesa e fundit, e cila nuk mund të jetë më pak se 10% e vlerës së kontratës, do të bëhet pas përfundimit të punimeve të kontraktuara, bazuar në raportin përfundimtar dhe lëshimin e çertifikatës për kryerjen e punëve nga personat e autorizuar – menaxheri apo ekipi për menaxhim të kontratës, në harmoni me dispozitat ligjore dhe kushtet e kësaj kontrate. Çdo pagesë duhet të aprovohet nga Zyrtari i Prokurimit dhe i financave të Autoritetit Kontraktues.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Deshmi 1: Lista e kontratave dhe kontratat

. Per LOT I Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 8 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore, A. Një inxhinjer te diplomuar i komunikacionit apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. B. Një inxhinjer te diplomuar i ndertimtaris-konstruktiv, apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. **2. Per LOT II Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 8 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore, A. OE lideri i grupit duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te elektroteknikes apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit .**

Per kete pike e kemi paraqitur listen e punetoreve qe jane 39 prej tyre se bashku me kontrata ashtu siq eshte kerkuar ne dosje te tenderit.

LISTA E PUNTOREVE PER VITIN 2020

SH."DRINI COMPANY"SH.P.K

Nr.	Emri dhe mbiemri	POZICIONI	VENDBANIMI	Numri personal nga letërnjoftimi	Datëlindja
1	Bali Dellova	Teknik i prodhimit-Shofer	Krushe e Madhe	1016261897	16.11.1970
2	Hatmi Gashi	Menagjer i ambientit	Rogovo-Gjakove	1003840499	12.06.1957
3	Isuf Gashi	Teknik i ndertimtarise-Shofer	Nagavc_Rahovec	1003207966	25.09.1974
4	Luljim Reshiti	Teknik i ndertimtarise	Krushe e Madhe	1005934075	25.09.1972
5	Qendresa Gashi	Administratore	Nagavc-Rahovec	1173777791	01.05.1988
6	Zarife Trolli	Inxhinjer i ndertimtarise-Konstruktiv	Grelkoc-Suhareke	1001336297	28.04.1969
7	Fatmir Gashi	Ekonomist-Drejtor	Nagavc_Rahovec	1003192462	22.02.1971
8	Milaim Gashi	Teknik i ndertimtarise-Pronar	Nagavc_Rahovec	1007066083	21.01.1968
9	Ramadan Pagarrizi	Inxhinjer i ndertimtarise-Konstruktiv	Dragobil-Malishevo	1016647060	05.03.1961
10	Alban M.Gashi	Arkitar	Nagavc-Rahovec	1176095136	03.01.1991
11	Bashkim Gashi	Perjegjes i Operatives	Nagavc	1233602597	20.09.1993
12	Sadik Bytyqi	Mekanik	xerxa-rahovec	1007065593	17.05.1971
13	Hazer Gashi	Ekonomist	Rogovo-Gjakove	1172916054	19.4.1987
14	Doshnor Hajredini	Shofer	Qendrese	1002534459	28.03.1976
15	Hilmi Duraku	Shofer	Krushe e Madhe	1002409883	22.06.1975
16	Nexhmedin Dellova	Shofer	Krushe e Madhe	1003209101	17.10.1973
17	Defrim Hajredini	Shofer	Qendrese	1002538543	30.03.1984
18	Bahti Duraku	Shofer	Krushe e Madhe	1003196174	23.12.1971
19	Besim Kryeziu	Shofer	Retije-Rahovec	1002602225	30.05.1971
20	Emir Xhaferi	Puntor-Teren	Prizren	1007598285	30.09.1979
21	Qibri Alija	Mjeshter	Skorobisht_Prizren	1016191694	15.12.1964
22	Defrim Krasniqi	Punetor	Koqe e Vogël	1003264021	23.12.196
23	Naim Bytyqi	Punetor	xerxa-rahovec	1002240820	01.12.1972
24	Blerim Duraku	Punetor	Krushe e Madhe	1030781291	19.01.1972
25	Xhevahir Muqaj	Punetor	Korishe	1003217201	30.10.1978
26	Pitim Sejfullahu	Mjeshter	Krushe e Madhe	1003764229	29.09.1966
27	Perparim Kabashi	Punetor	Nagavc_Rahovec	1243030622	01.03.1996
28	Read Munqe	Punetor	Prizren	1230508280	18.04.1980
29	Osman Jusufi	Mjeshter	Skorobisht_Prizren	1016485116	21.08.1960
30	Shaban Kastrati	Roje	Istrig	1006140633	17.06.1966
31	Albina Gashi	Ekonomiste	Nagavc	1231512132	03.08.1994
32	Imer Sejfullahu	Puntor-Teren	Krushe e Madhe	1005935543	29.05.1960
33	Shukriu Hoti	Puntor-Teren	Krushe e Madhe	1030462465	01.02.1964
34	Hasan Morina	Roje	Radoste-Rahovec	1016468157	25.06.1944
35	Gzim Vastja	Roje	Prizren	1008037104	09.12.1971
36	Skender Berisha	Roje	Kontelbrave	2002534307	03.10.1956
37	Muhamet Gashi	Mjeshter	Nagavc	1003196387	30.06.1969
38	Perparim Dellova	Shofer	Krushe e Madhe	1173775071	02.10.1987
39	Pitim Dellova	Shofer	Krushe e Madhe	1173775080	02.10.1987

SH. DRINI COMPANY SH.P.K

Drejtori: Fatmir Gashi

Nënshkrimi...

Deshmi 2: Lista e punetoreve

3. OE duhet të emëroj menaxherin e projektit

Ne dosje e kemi prezantuar deklaraten per caktimin e menagjerit te projektit ku me te i kemi derguar te gjitha dokumenteet e kerkuan si CV, Diploma etj,

MATCAL SOLUTION sh.p.k
10000, Prishtine, Kosove

SH. "DRINI COMPANY" sh.p.k.
N.U.I. 810608335, Adresa: Rr."Ernes Maurshu",Llam 2/1, Prizren
Email: ddshaqiri@yahoo.com
Banka Ekonomike 1404000003506967

Deklarate per caktimin e projekt menaxherit LOT 2

Titulli: Lot I-Ndertimi i rrethojës së të dy anet e rrugës Nënë Tereza në Fushë Kosovë LOT II-Vendosja e ndriçimit në vendëkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë

Nr i prokurimit	612-20-2868-5-2-1
Nr i brendshëm	612 20 047 521

Investitori: KUVENDI KOMUNAL I FUSHE KOSOVES

Ne si OE ofertues sh. Drini Company sh.p.k & MATCAL SOLUTION sh.p.k deklarojmë se menaxher i projektit per LOT 2 do te jete z. OSMAN HOTI inxhiniere e diplomuar e ELEKTROTEKNIKES.

SH. DRINI COMPANY-sh.p.k

Nënshkrimi.....

Data/Vendi 06.07.2020 -Prizren

Matcal Solutions sh.p.k

Nënshkrimi.....

Data/Vendi 06.07.2020 -Prishtinë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e paraqitur nga OE "Matcal Solutions SH.P.K" Prishtinë, ankesë me nr: 722/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, gjegjësisht LOT 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "LOT II-"Vendosja e ndriçimit në vendëkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë" me nr. të prokurimit: 612-20-2868-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Fushë Kosovë.

4.OE duhet te posedoj pajisjet teknike te nevojshme min. një autoshportë për ngritje në lartësi per LOT II.

Ne ne dosje te tenderit e kemi paraqitur marrveshjen per shporte me kompaninen Intercorp,

Marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve

Ne mes te:

INTER CORP SH.P.K

Rr.Mustafa Hoxha, Prishtinë, Kosovë

Dhe

SH. "DRINI COMPANY" sh.p.k.

N.U.I. [illegible], Adresa: Rr."Ernest Koliqi", Ndërt 2/1, Prizren

Mjetet do te japen ne shfrytëzim per afat te pacaktuar per projektin:

Titulli: Lot I-Ndertimi I rrethojës në 15 dy anet e rrugës Nënë Tereza në Fushë Kosovë LOT II-Vendosja e ndriçimit në vendkalimet e këmbësorevu në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë

Nr I prokurimit	612-20-2868-5-2-1
Nr I kërkesës	612 20 047 521

Autoriteti kontraktues: KUVENDI KOMUNAL I FUSHE KOSOVES

Mjete te cilat japen te shfrytëzim janë:

	Tipi	Pershkrimi
1	Mercedes 308D Targa: 01-575-MG	Kamionet me shporte 2 dyer

Ne emër te kompanisë:

INTER CORP SH.P.K

SH. "DRINI COMPANY" sh.p.k.

Si heren e pare edhe tani fare AK ne menyre tendencioze na elimonon neve edhe pse i kemi te gjitha dokumentete e kerkuara ne piken 9.1&9.2.

Gjithashtu habitemi se si AK deklaron ne letren standarde se nuk e permbushim kriterin e cmimit me te ulet, ku ne jemi brenda buxhetit, dhe te gjithe operatoret qe kane cmim me te lire se ne nuk i plotesojne kerkesat e AK.

Ketu shihet qarte tendenca e AK per te na eliminuar ne ne menyre te qellimshme duke shkelur edhe mbi vendimin e OSHP-se.

AK me rasti e vleresimit te ketij projekti ka shkelur keto dispozita ligjore:

- **NENI 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, par. 1.1, par. 1.2, par. 1.3.** .
- **Neni 43 – RrUOPP-se – Njotimi i tenderueseve kandidateve, sepse nuk na ka njoftuar per arsyet e eliminimit tone.**
- **Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave,**
- **Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale**
- **Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,** sepse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.
- **Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,** sepse AK nuk e ka vleresuar tenderin dha njoftuar kandidatet sipas dispozitave ligjore primare dhe atyre sekondare.

Kerkojme nga Paneli shqyrtues i OSHP-se qe ankesen tone ta aprovoje si te bazuar dhe ta kthej lenden ne rivleresim, pasi qe gjate vleresimit komisioni vleresuses ka bere shkelje te dispozitave ligjore fillimisht duke mos na njoftuar per arsyet eliminimit e me pastaj duke e anuluar LOT 2, pa asnje baze, pasi qe jemi OE i pergjegjshem.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Arsyetimi i AK-së në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, në këtë rast të OE ankues.*

ARSYETIM

Jeni eleminuar per arsye se nuk keni përmbushur kerkesen 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1 dhe 2 qeshte kërkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate si dhe nuk e përmbushni kriterin e çmimit me te ulet.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk keni qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bedri Obertinca, _____

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit) *(Nënshkrimi)*

Fakt 2: *Data e njoftimit për kontratë e aktivitetit të prokurimit në fjalë.*

KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 15.06.2020

Nr i Prokurimit	**612-20-2868-5-2-1**
Nr i brendshëm	**612 20 047 521**

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

Fakt 3: *Kontrata referencë listuar nga OE ankues (partneri me Komunën e Prishtinës ku thuhet që punët kanë filluar me datën me 12.08.2019 dhe kanë përfunduar 30.08.2019. Për sqarim, Njoftimi për Dhënie të Kontratës për të njëjtin aktivitet është bërë me 19.07.2019.*

Konstatim

"Ndërtimi i Semaforëve, modernizimi dhe pajisjet tjera për siguri në komunikacion"- në qytetin e Prishtinës.

Me rastin e fillimit të punëve për "Ndërtimi i Semaforëve, modernizimi dhe pajisjet tjera për siguri në komunikacion",

Punët janë realizuar nga NTSH "Ekoinvest", nga Prishtina, në cilësinë e punëkryesit ndërsa investuesi është Komuna e Prishtinës.

Menaxheri i Projektit është Halil Halili, ndërsa Organi Mbikëqyrës është Enver Kadriu dhe Habib Qorri, zyrtar Komunal.

Punët kanë filluar me datën me 12.08.2019 dhe kanë përfunduar 08.30.2019

Të gjithat janë evidentuar në teren dhe janë të konstatuara nga menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës. Duke u bazuar ne disa pjese disa nga pozicionet nuk ka qen të mundshme, të realizohen pasi nuk ka pas mundësi te vendosen ne ato pjese ku janë parapa për shkak kushteve teknike të udhëkryqeve, 1 shtylla gjysemportak, 2 shtylla 3.2m, 2 shtylla 4.2m, 1 llaterna (semafor) 300Ø (1 copë),2 timer 300 Ø (2cop), të gjithat do të shfrytëzohen sipas nevojave apo kërkesave të organit mbikëqyrës.

Marrëveshja për ekzekutimin e punëve është arritur në mes Departamentit të Prokurimit dhe Punëkryesit.

Sipas sasisë së punëve të cilat janë evidentuara në situacionin, vlera përgjithshme e tyre sipas kontratës Nr.616-19-098-521 është 149,576.00 € euro, siç është dhënë nga oferta financiar e Kontraktuesit.

Fakt 4: *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale paraqitur nga Autoriteti Kontraktues. Mosplotësimi adekuat i kërkesave, gjegjësisht pikave 1 & 2 kanë qenë po ashtu arsyet e eliminimit të OE ankues.*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **<u>1.Operatori</u> Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 322 500.00 euro per LOT I, dhe 138 000.00 euro per LOT II.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete sa paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **<u>1.Një</u> listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

	2. Per LOT I Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 8 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore, A. Një inxhinjer te diplomuar i komunikacionit apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. B. Një inxhinjer te diplomuar i ndertimtaris-konstruktiv, apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit. 2. Per LOT II Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 8 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore, A. OE lideri i grupit duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te elektroteknikes apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit .	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE. Per piken a. dhe b. duhet te deshmohet me kopje te diplomes universitare te noterizuar, kontraten e punes apo parakontrate, leterreference nga punedhenesi ose qfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per punet dhe pervojen e meparshme inxhinjerike ne lemin e caktuar.**	

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr. 534/20
Data/Datum 04.09.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.534/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, dhe z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Matcal Solucion" SHPK, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: LOT II - "Vendosja e ndriqimit në vendkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë" me nr. të prokurimit: 612-20-2868-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal - Fushë Kosovë me datën 03.09.2020, mori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit OE "Matcal Solucion" SHPK kundër kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit: LOT II - "Vendosja e ndriqimit në vendkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë" me nr. të prokurimit: 612-20-2868-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Fushë Kosovë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: LOT 2 - "Vendosja e ndriqimit në vendkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë" me nr. të prokurimit: 612-20-2868-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Fushë Kosovë, dhe lënda kthehet në rivlerësim për LOT 2.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

- **Paraprakisht, për këtë aktivitet të prokurimit vecse është nxjerrur një vendim nga Paneli i OSHP-së. Marrë parasysh natyrën e pretendimeve në ankesën e tanishme, ankesa, gjegjësisht pretendimet do të shqyrtohen konform Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve**

Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Fillimisht, Eksperti vlerëson që refuzimi i tenderit, respektivisht arsyetimi i tij duhet bërë konform nenit 108/A të LPP-së, gjegjësisht Zgjidhja Preliminare e mosmarrëveshjeve, kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni nga AK, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Do të thotë, arsyetimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duhet të jetë i arsyetuar dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj.

Sa i përket pretendimit të AK-së ku thuhet që OE ankues nuk përmbush kërkesën 9.1 & 9.2 – Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 1 dhe 2 dhe kriterin me cmimin më të ulët, Eksperti vlerëson që një arsyetim i tillë mbi eliminimin e OE ankues është i bazuar, duke argumentuar si më poshtë:

- Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, gjegjësisht pika 1, AK kërkon që **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 322 500.00 euro per LOT I, dhe 138 000.00 euro per LOT II.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme,** ndërsa si dëshmi dokumentare **Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.** Tek Deklarata për themelimin e grupit, palët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit i cili është Drini Company SH.P.K. Në listën e kontratave të paraqitura nga ky i fundit në tenderin e grupit e OE ankues, fushëveprimi i kontratave ka të bëjë me: ndërtimin/asfaltimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale, duke mos përkuar kështu me natyrën e aktivitetit të prokurimit, gjegjësisht **LOT 2 "Vendosja e ndriqimit në vendkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë".** Sa i përket kontratës së përmendur si referencë nga OE ankues, lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe Grupit të OE "Eko Invest & Drini Company SHPK" me lider NTSH "Eko Invest" me titull *"Ndërtimi i semaforeve, modernizimi dhe pajisjet tjera per siguri në komunikacion". konform interpretimit të KRPP-së në pyetjen se "A mund të pranohet Referenca e lëshuar në emër të konsorciumit (grupit të Operatorëve Ekonomik) nga Autoriteti Kontraktues qind për qind (100%) për secilin anëtar të grupit apo në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të konsorciumit?"*, **vlera e kontratës referencë merret në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të Operatorëve Ekonomik dhe jo si e plotë.** Për më tepër, shih përgjigjen e dhënë nga KRPP më poshtë:

26. Një OE pyet: A mund të pranohet Referenca e lëshuar në emër të konsorciumit (grupit të Operatorëve Ekonomik) nga Autoriteti Kontraktues qind për qind (100%) për secilin anëtar të grupit apo në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të konsorciumit?

KRPP konform nenit 87 paragrafi 2.8 LPP-së nr.04/L-042, jep këtë përgjigjëje:

Ligji i Prokurimit Publik si dhe legjislacioni dytësor i nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të veçantë me të cilën përcaktohet se sa përqind (%) të projektit duhet të realizohet nga lideri dhe përqindja tjetër nga anëtari apo anëtarët tjerë të konzorciumit. Andaj duke pasur parasysh këtë situatë KRPP mendon se: Referenca e lëshuar në emër të konsorciumit mund të pranohet nga Autoriteti Kontraktues në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të Operatorëve Ekonomik . Operatori Ekonomik mund ti drejtohet Autoritetit Kontraktues i cili e ka lëshuar referencën që të caktoj përqindjen e punëve të kryera nga secili anëtar i konsorciumit . Përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit, Autoriteti Kontraktues është i obligu ar ta përcaktoj në referencë.

- Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, gjegjësisht pika 2, AK kërkon që **Per LOT II Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 8 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore, A. OE lideri i grupit duhet te ket një inxhinjer te diplomuar te elektroteknikes apo bachelor me min.tri vite pervoje pune pas diplomimit,** ndërsa si dëshmi dokumentare **Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE. Per piken a. dhe b. duhet te deshmohet me kopje te diplomes universitare te noterizuar, kontraten e punes apo parakontrate, leterreference nga punedhenesi ose qfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per punet dhe pervojen e meparshme inxhinjerike ne lemin e caktuar.** Në listën e punëtorëve të dorëzuar nga grupi i OE ankues, figuron Inxhineri i diplomuar i elektronikës ku si dëshmi dokumentare ekziston kopja e diplomës universitare e noterizuar dhe CV me referencat e Z. Osman Hoti mirëpo **kontrata e Inxhinerit në fjalë është në mes të këtij të fundit dhe kompanisë NTSH "Ekoinvest"** që nga viti 2011 dhe jo me liderin e grupit të OE ankues në fjalë, shënuar edhe në CV dhe Referencën e lëshuar nga kjo e fundit drejt personit në fjalë (shih cv dhe referencën më poshtë).

OSMAN HOTI

[illegible]

EDUCATION

1972 - 1979 University of Prishtina, Prishtine, Kosovo
Technical faculty, engineer of electrotechnics
- Diploma

WORK EXPERIENCE

1980 - 2011 Kosovo Energetic Corporation Prishtine, Kosovo
Chief of electric maintenance
- Responsible for all electric installations and maintenance of electrical devices

2000 - 2011 Silbertang Inc. Prishtine, Kosovo
Manager
- Responsible for project management

2011 – ongoing N.t.sh. "Ekoinvest" Prishtine, Kosovo
Manager of electrical department
- Person responsible for implementation of electrical projects and electrical components

EKO INVEST

N.T.SH. EKOINVEST
Add: str. Agim Ramadani C1/9
Tel: +377 45 234 568
Fax: +381 38 227 997

Prishtine: 03.05.2019

Te nderuar,

Bazuar në kërkesën e z. Osman HOti si menaxhues i departamentit Inxhinierise Elektrike, unë si reprezentues i kompanisë NTSH. Ekoinvest lëshojë këtë:

Referencë

z. Osman Hoti është i punësuar që nga viti 2011 në cilësinë e menaxherit të departamentit të Inxhinierise Elektrike ne kuadër te kompanisë NTSH Ekoinvest.

Qe nga ajo kohe deri me tani ka udhëhequr dhe realizuar dhjetëra projekte ne kete fushë.

Fokusi kryesor si menaxher i departamentin ka qene ne projekte mbikëqyrjes se anës elektrike ne projekte kapitale te realizuara nga kompania jone. Projektet kane perfshire riparime dhe instalime kapitale ne projekte te mëdha te realizuara per Korporaten Energjetike te Kosoves, KOST, Posta dhe Telekomi i Kosoves, Komutat e Kosoves , etj.

Te zotëri Osmani lehtë është ti vërehet modestia, sjellja e shkëlqyer, vetëdisplina, si dhe vetitë pozitive të karakterit duke u veçuar si një personalitet i shkëlqyer dhe profesionist.

Sa i përket pretendimit të OE ankues që Autoriteti Kontraktues ka shkelur vendimin e OSHP-së duke mos marrur për bazë vendimin e këtij të fundit, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, e gjen pretendimin si të pabazuar. Një arsyetim dhe interpretim i konstatimit të tillë vjen edhe komfort dispozitave ligjore ku janë respektuar parimet kryesore të procedurës së vlerësimit, gjegjësisht nenit 41.3 të RRUOPP. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues me të drejtë në vendimin e tyre për refuzim të ankesës përmend nenin 12, paragrafin 7 të "Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave" ku thuhet që "një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar".

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi për anulim të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "LOT II-"Vendosja e ndriqimit në vendëkalimet e këmbësoreve në te dy anet e rruges Nënë Tereza në Fushë Kosovë" me nr. të prokurimit: "612-20-2868-5-2-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Fushë Kosovë, të mbetet në fuqi dhe të respektohet vendimi i AK-së. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e pabazuar dhe vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **KK Fushë Kosovë**
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues **"Matcal Solutions SHPK" Prishtinë**